

Nr. regj. 18235/2012

03-2731/  
03.08.2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, gjyqtaria Azra Cakolli me procesmbajtësen Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Shkelzen(Mehmet)Maliqi, nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 5, 6 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 27.07.2012 morri këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Shkelzen(Mehmet)Maliqi, i lindur më 26.10.1947 në Rahovec, tani me vendbanim në Rrugën "Nazim Gafuri", nr. 27, në Prishtinë, ka të kryer Fakultetin Filozofik, Këshilltarë Politik, i martuar baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

### **Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse si zyrtarë i lartë publik, Këshilltar Politik në Ministri të punëve të jashtme, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31mars 2012, në Agjencinë kundër korrupsion, sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5, 6 e neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, andaj i shqiptohet

## **D Ë N I M**

**Me gjobë në shumë prej 2000(dymijë) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh,** pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Paguesa bëhet në ndonjëren agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30(tridhjetë) ditësh.** Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga **5 €,** në afat dhe xhirrollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.


## **A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsionit, në Prishtinë,** i parashtrori kësaj gjykate kërkesën nr. 01-1816/2012 më datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit. Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk ka pas dijëni se duhet të deklaronte pasurinë dhe se pranon kundërvajtjen duke premtuar se tani e tutje do ti kryen obligimet duke treguar keqardhje për kundërvajtjen e kryer. Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi të deklaratës së të pandehurit, vlerësimi të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë pasi që më afatin e paraparë ligjor deri 31.03 2012, nuk ka bërë deklarimin e pasurisë ashtu si e parasheh ligji.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, andaj i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
**Nr. Regj. 18235/2012, më datë 27.07.2012**



**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimin të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.